

Shëndeti dhe siguria në punë – Pastrimi

COVID-19 përhapet përmes spërkalave respiratore të prodhuara kur një person i infektuar kollitet apo teshtitet. Një person merr virusin duke prekur një sipërfaqe apo objekt që ka virus mbi ate dhe pastaj prek gojën, hundën apo sytë e vetë.

Vendet e punës duhet të pastrohen së paku një herë në ditë. Pastrimi me detergjent dhe ujë është i mjaftueshëm.

Ju duhet të:

- minimizoni prekjën e sipërfaqeve; vendosni shenja dhe mbështetni punëtorët tuaj duke përkujtuar klientët
- reduktoni numrin e pikave të prekjës për punëtorët
- siguroni mjete për pastrim të duarve apo sanitizues të duarve në pikat e hyrjes dhe daljes nëse është e mundshme.

Si të pastroni dhe dezinfektoni

Para se një sipërfaqe të dezinfektohet, me rëndësi është që së pari të pastrohet. Papastërtia dhe ndotja mund të zvogëlojnë aftësinë e dezinfektantëve për të mbytur mikrobet.

Ju duhet t'i siguroni punëtorëve tuaj produkte të përshtatshme për pastrim dhe dezinfektues dhe mjete personale mbrojtëse, dhe të sigurohuni që ata janë të trajnuar se si t'i përdorin ato.

Çfarë është dallimi në mes pastrimit dhe dezinfektuesit?

Pastrimi do të thotë largimi fizik i mikrobeve (bakterieve dhe viruseve), papastërtive dhe ndotjeve nga sipërfaqet duke përdorur tretësirë me detergjent dhe ujë .

Dezinfektimi do të thotë përdorimi i kemikaleve për të mbytur mikrobet mbi sipërfaqe. Zakonisht dezinfektuesit nevojiten vetëm nëse një sipërfaqe është e kontaminuar me virus.

Cilat hapësira duhet të pastrohen dhe dezinfektohen, dhe sa shpesh?

Cilëtdo sipërfaqe që shpesh preken duhet të pastrohen rregullisht, siç janë dorezat e dyerve, banaket, telefonat, EFTPOS (pajisjet elektronike) dhe hapësirat siç janë toaletet.

Sipërfaqet që dukshëm janë të papastërta, apo ka derdhje mbi ato, duhet të pastrohen sa më shpejt që është e mundur.

Dezinfektimi është i nevojshëm nëse ka pasur rast të konfirmuar apo të dyshuar të COVID-19 në vendin e punës. Nëse në vendin tuaj të punës shumë njerëz hyjnë brenda ditës, rekomandohet që gjithashtu të bëni dezinfektim të rregullt.

Çfarë nëse ka rast të COVID-19 në vendim tim të punës?

Nëse keni rast të COVID-19 në vendin e punës, autoriteti shëndetësor i shtetit apo territorit tuaj ([state or territory health authority](#)) do t'ju tregoj çfarë të bëni. Ndjekni udhëzimet e tyre.

Vendi juaj i punës do të duhet të pastrohet dhe dezinfektohet tërësisht para se njerëzit të kthehen në vendin e punës.

Çfarë me sendet personale të punëtorëve?

Ju duhet t'i thoni punëtorëve tuaj që rregullisht të pastrojnë sendet personale që i përdorin në vendin e punës, siç janë gotat dhe telefonat, duke përdorur peçetë dezinfektuese.

Nëse gjithçka është shitur, a mund që vetë të bëj një dezinfektues?

Dezinfektuesit e blerë në shitore përmbushin standardet qeveritare, ashtu që e dini se ato funksionojnë. Sido që të jetë, ju mund të përgatitni një tretësirë dezinfektuese duke përdorur zbardhues dhe ujë. Sigurohuni që me kujdes t'i përdorni kemikalet pasi që ato janë të rrezikshme.

Çfarë duhet të mbajnë punëtorët e mi për të pastruar?

Në shumicën e rrethanave, nuk është e nevojshme që punëtorët të mbajnë veshje mbrojtëse për të pastruar vendin e tyre të punës. Si pikë nisjeje:

- dorezat janë një kërkesë minimale
- maskat kirurgjike duhet të mbahen nëse pastrohet një hapësirë e prekur nga një rast i dyshuar apo i konfirmuar me COVID-19
- kombinizone dhe kostume për një përdorim nuk janë të nevojshme
- duhet të siguroni mjete mbrojtëse personale dhe të trajtoni punëtorët tuaj se si të përdorin ato në mënyrë të sigurt.

Një produkt antibakterial a do ta mbyt COVID-19?

Produktet antibakteriale janë të përcaktuar për të mbytur bakterie. Sidoqoftë, COVID-19 është i shkaktuar nga një virus e jo nga bakterie, ashtu që nuk është i domosdoshëm një produkt antibakterial.

Për pastrimin e duarve, efektive është larja e duarve me sapun dhe me ujë të ngrohtë.

Më shumë informacione

Për më shumë informacione në lidhje me COVID-19 dhe për shëndetin dhe sigurinë në punë, vizitoni uebfaqen [Safe Work Australia website](https://www.swa.gov.au/coronavirus).